



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Thirrje për propozim në grande të vogla, për OJQ-t,ë në Mitrovicën veriore si dhe OJQ-të që veprojnë në komunat Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan për iniciativa të përbashkëta me qëllim të integritetit të komuniteteve

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal lanson grandin për OJQ-të, e Mitrovicës Veriore, Leposaviqi, Zubin Potok, dhe Zveçan me qëllim të promovimit të iniciativave të përbashkëta për komunitetet që jetojnë në këto qytete (50 % e Grandit është i dedikuar për OJQ-të në Veri të Mitrovicës 50% e Garantit është i hapur edhe për OJQ-të që veprojnë në komunat Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) të cilat mund të aplikojnë me projektet e tyre.

Granatet do të jepen në shuma prej 1,000.00 Euro deri 5,000.00 Euro.

MAPL fton të gjitha subjektet e shoqërisë civile që veprojnë në këto qytete të aplikojnë me qëllim të përfitimit nga ky grand i cili do të fokusohet kryesisht në këto fusha (duke mos kufizuar temat):

1. Kulturë:

- Panair për kulturën (aktivizimi i nxënësve të të dy pjesëve për paraqitjen e veshjeve tradicionale, elementeve tjera të traditës, muzikës, veglave, etj.) në qendrën e kulturës;
- Gare në mes të rinjve në muzike dhe instrumente;
- Në bashkëpunim me disa qendra të vallëzimit mund të organizojmë një paraqitje të shumë zhanreve të vallëzimit tradicional dhe modern në mes dy shoqërive .

- Garë në mes grupeve për njohuritë e përgjithshme dhe me tema të caktuara (decentralizimi, menaxhimi, etj.);
- Debate në grupe të përziera me formën e debatit Carl Poper;
- Prezantime të grupeve të dy pjesëve në lidhje me drogën prostitucionin duhanin etj;
- Projekte tjera por që nuk dalin nga koncepti i promovimit dhe zhvillimit të kulturës.

2. Promovimi i Zhvillimi Ekonomik:

- Organizimi i tryezës së përbashkët me bizneset Veri/Jug për të diskutuar mundësitë e bashkëpunimit;
- Organizimi i një minipanairi me bizneset veri-jug;
- Projekte tjera por që nuk dalin nga koncepti i promovimit të zhvillimit ekonomik.

3. Aktivitet Sportive:

- Turnir në futboll, basketboll; volejboli etj;
- Projekte tjera por që nuk dalin nga koncepti i promovimit dhe zhvillimit të aktiviteteve sportit.

4. Çështje sociale (antitrafikim me qenie njerëzore, varfëria, papunësia, etj)

- Prezantime të grupeve të dy pjesëve në lidhje me drogën prostitucionin duhanin etj.
- Organizimi i debateve të përbashkëta lidhur me rastet sociale veri-jug;
- Projekte tjera por që nuk dalin nga koncepti i promovimit dhe zhvillimit të çështjeve sociale.

Kriteret për Aplikim:

- Aktivitetet nuk duhet të zgjasin më shumë se 2 muaj dhe jo me pak se një muaj;
- Shpenzimet administrative mund të mbulohen deri në max. 25 % të buxhetit të përgjithshëm. Shpenzime administrative konsiderohen: pagesën e koordinatorit të projektit, shpenzimet administrative të zyrës (material shpenzues, interneti/telefoni etj.)

Programi nuk përkrahë shpenzimet për:

- Organizimet që zgjasin më pak se një muaj;
- Inventar, pajisje dhe qiranë për zyrë;
- Publikime (gazeta, revista, etj);
- Nuk do të përkrahen projektet e OJQ-ve që tek të rinjtë mund të kenë ndikim politik, religjioz apo profitabil.

Kërkesat (Projekt propozimet) duhet të përmbajnë:

1. Projekt propozimin (duke përfshirë edhe lokacionin, kohëzgjatjen, numrin e pjesëmarrësve, numrin e përfituesve, etj);
2. Buxhetin e detalizuar si dhe arsyetimin e linjave buxhetore;
3. Afatin e precizuar kohor për implementim;
4. Përshkrimin e detalizuar të përfituesve dhe pjesëmarrësve;
5. Përshkrimin e detalizuar të kapaciteteve menaxhuese të organizatës *(përfshirë personelin, pajisjet dhe aftësinë për të menaxhuar buxhetin e paraparë për aktivitete, etj);*
6. Një kopje që dokumenton regjistrimin e OJQ-së/ve, konform ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës;
7. Referencat për pune të ngjashme;
8. Aplikantët duhet të kenë xhirollogari në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.

Të gjithë të interesuarit për aplikim mund të marrin informata në Qendrën për Shërbime të Qytetarëve (QSHQ) në veri të Mitrovicës përmes tel: 038 200 35 084 , ose në uebfaqen e MAPL-së <http://www.mapl-rks.org> .

Propozimet e kompletuara të mbyllura në zarf munde të dorëzohen në Qendrën për Shërbime të Qytetarëve në lagjen e Boshnjakëve Mitrovica Veriore gjere me datë 03 Shkurt 2012, në ora 14:00.